



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 8 mars 2021
Nr. Ref.: VE 1723/21

VENDIM **PËR NDËRPRERJEN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS**

në

rastin nr. KO103/20

Parashtrues

**Fitore Pacolli dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit
të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë “së veprimit të Presidentit të Republikës
së Kosovës të 3 qershorit 2020”**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Fitore Pacolli, Rexhep Selimi, Yllza Hoti, Liburn Aliu, Fatmire Mullhaxha Kollçaku, Arbërie Nagavci, Hekuran Murati, Hajrullah Çeko, Saranda

Bogujevci, Jahja Koka, Mefail Bajçinovci, Valon Ramadani, Mimoza Kusari-Lila, Fitim Uka, Shpejtim Bulliqi, Artan Abrashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Labinotë Demi – Murtezi, Alban Hyseni, Gazmend Gjyshinca, Arta Bajraliu, Enver Haliti, Agon Batusha, Dimal Basha, Fjolla Ujkani, Fitim Haziri, Elbert Krasniqi, Eman Rrahmani, Salih Zyba, (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

2. Parashtruesit e kërkesës në procedurën para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i përfaqëson deputetja Fitore Pacolli.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së veprimit të Presidentit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidenti) të 3 qershorit 2020, që, sipas pretendimeve të tyre, ka ndodhur *“gjatë vizitës së tij në shtëpinë/banesën private të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Haxhi Shalës (në tekstin e mëtejme: deputeti), me qëllim që përmes ndikimit të tij politik ndaj deputetit, ka arritur ta ndryshoi mendimin dhe veprimin e tij, në lidhje me zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës në seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të datës 03.06.2020”*.
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që duke përdorur mekanizma jokushtetues, Presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës, në veçanti të nenit 83 [Statusi i Presidentit], nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 14, nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] në lidhje me paragrafin 3, nenin 7 [Vlerat], nenin 65 [Kompetenca e Kuvendit], paragrafi 8, dhe nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Parashtruesit gjithashtu kërkojnë që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore publike.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 6 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar], të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 44 [Saktësimi i kërkesës] dhe 45 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 75 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.6 të Kushtetutës dhe me nenet 44 dhe 45 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 30 qershor 2020, parashtruesit e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë. Përveç kërkesës me shkrim, parashtruesit e kërkesës gjithashtu dorëzuan; Procesverbalin nga seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtur më 3 qershor 2020; CD me deklaratat: *“Deklarata 1 – Deputeti NISMA, Haxhi Shala – Për momentin vota ime është kundër Qeverisë*

Hoti. Deklarata 2 – Debat Plus me Ermal Pandurin – Vota Vendimtare, Deklarata 3. – Haxhi Shala bindet nga Thaçi e Haradinaj për votën pro Qeverisë, Deklarata 4. – Thaçi komenton vizitën e tij në shtëpinë e Haxhi Shalës, Deklarata 5. – Thaçi: Haxhi Shala e kërkoi opinionin tim për votimin e Qeverisë Hoti – Klan Kosova”.

8. Më 30 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi- Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).
9. Më 2 korrik 2020, parashtruesit u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.
10. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Presidentin për kërkesën, duke e udhëzuar atë që ta dorëzojë përgjigjen ndaj kërkesës në Gjykatë deri më 15 korrik 2020. Kërkesa iu dorëzua edhe Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, për të paraqitur komentet e tij, nëse ka, në Gjykatë deri më 15 korrik 2020, Kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, me udhëzimin që t’ua dorëzojë kërkesën të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që nënkupton edhe deputetin z. Haxhi Shala, si dhe Institucionit të Avokatit të popullit, z. Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, me udhëzimin që përgjigjen e tij në Gjykatë mund ta dorëzojë deri më 15 korrik 2020.
11. Gjykata vëren se komente në kërkesën e 30 qershorit 2020, në afatin e përcaktuar, Gjykatës nuk i kanë dorëzuar: Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, asnjë nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht as deputeti z. Haxhi Shala, si dhe as Institucioni i Avokatit të Popullit. Më 15 korrik 2020, Presidenti e dorëzoi përgjigjen e tij ndaj pretendimeve të bëra në kërkesën e parashtruesve.
12. Më 8 tetor 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesen e parashtruesve të kërkesës për pranimin e përgjigjes së parashtruar nga Presidenti. Të njëjtën ditë, përgjigja e Presidentit ndaj pretendimeve në kërkesën e parashtruesve iu dërgua Kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me udhëzimin që t’u sigurojë të gjithë deputetëve një kopje të përgjigjes, si dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.
13. Më 5 nëntor 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dha dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës.
14. Më 5 nëntor 2020, Kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, filloi ta ushtrojë funksionin e ushtrueses së detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.
15. Më 27 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese me ç’rast gjyqtarët dhanë komentet e tyre lidhur me raportin. Gjyqtarët u pajtuan që të bëhet plotësimi i raportit sipas komenteve të paraqitura nga ta.

16. Më 10 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi versionin e plotësuar të raportit të Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të urdhërojë ndërprerjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës. Prandaj, në pajtim me nenin 113.6 të Kushtetutës, nenet 44 dhe 45 të Ligjit dhe paragrafin (5) të rregullit 75 të Rregullores së punës, Gjykata vendosi të urdhërojë ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës së parashtruesve.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
18. Më 27 nëntor 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) konfirmoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend.
19. Më 26 dhjetor 2019, u konstituua Kuvendi i Republikës së Kosovës.
20. Më 20 janar 2020, Presidenti nxori dekret me të cilin z. Albin Kurti i propozohet Kuvendit si kandidat për Kryeministër për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).
21. Më 3 shkurt 2020, Kuvendi zgjodhi Qeverinë me Kryeministrin z. Albin Kurti.
22. Më 20 mars 2020, një numër i caktuar i deputetëve të Kuvendit parashtruan në Kryesinë e Kuvendit mocion mosbesimi ndaj Qeverisë.
23. Më 25 mars 2020, Kuvendi miratoi mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë.
24. Më 22 prill 2020, Presidenti kërkoi nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK) ta propozojë emrin e kandidatit për Kryeministrin e ri të Qeverisë.
25. Më 30 prill 2020, LDK-ja propozoi z. Avdullah Hoti, si kandidat për Kryeministër. Të njëjtën ditë, Presidenti lëshoi Dekretin nr. 24/2020, me të cilin ia dha mandatin z. Avdullah Hoti, si kandidat për kryeministër nga radhët e LDK-së.
26. Më 30 prill 2020, Lëvizja Vetëvendosje (në tekstin e mëtejme: LVV) dërgoi kërkesë në Gjykatë për interpretimin e Dekretit Presidential nr. 24/2020 të 30 prillit 2020.
27. Më 1 qershor 2020, Gjykata nxori Aktgjykimin nr. KO 72/20, me të cilin deklaroi "*që dekreti nr. 24/2020 i Presidentit është në pajtim me Kushtetutën*".
28. Më 2 qershor 2020, Kryesia e Kuvendit vendosi që më 3 qershor 2020, të mbahet një seancë e jashtëzakonshme plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës me pikën e vetme të rendit të ditës, formimin e Qeverisë.
29. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë se më 3 qershor 2020, gjatë seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit, që mund të vërtetohet nga procesverbali,

deputeti Haxhi Shala, gjatë adresimit të tij drejtuar deputetëve të Kuvendit *“ndryshon mendjen në lidhje me deklaratën e tij që e ka dhënë më 1 qershor 2020, duke theksuar ‘Faleminderit kryesues! Të nderuar deputetë, Jemi dëshmitarë të shumë ngjarjeve këto ditë në Kosovë, sidomos rrëzimi i Qeverisë dhe fillimin e themelimit të Qeverisë së re. Para dy ditësh kam deklaruar se nuk do ta votoj Qeverinë Hoti për arsye të monopolizimit të partisë Nisma për Kosovën nga dy persona. Por, mbrëmë, pas vizitës që kam pasur në familjen time nga Presidenti dhe Ish kryeministri Haradinaj, kam ndërruar mendje, dhe vota ime do të jetë për këta dy persona, pro Qeverisë Hoti’.”*

30. Të njëjtën ditë, Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjodhi Qeverinë me 61 vota për, 24 kundër dhe 1 abstenim, me Kryeministër z. Avdullah Hotin.
31. Më 5 nëntor 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dha dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës.
32. Më 5 nëntor 2020, Kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, filloi ushtrimin e funksionit të ushtrueses së detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

33. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë që duke përdorur mekanizma antikushtetues, Presidenti ka bërë shkelje serioze të Kushtetutës, në veçanti të nenit 83 [Statusi i Presidentit], nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 14, nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] në lidhje me paragrafin 3, nenin 7 [Vlerat], nenin 65 [Kompetenca e Kuvendit], paragrafi 8, dhe nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës.
34. Parashtruesit në kërkesën e tyre pretendojnë që, *“çdo institucion kushtetues i ka kompetencat konkrete kushtetuese të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë. Në lidhje me këtë, Presidenti i Republikës së Kosovës është institucion kushtetues, i cili përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës dhe ushtron kompetencat e tjera kushtetuese të përcaktuara takstativisht në nenin 84 të Kushtetutës së Kosovës. Presidenti i Republikës së Kosovës si pushtet neutral apo si përfaqësues i pushtetit asnjans, pra, që qëndron mbi palët, nuk hyn në ndarjen e pushteteve dhe nuk kryen asnjë funksion ekzekutiv në drejtimin politik të vendit”*.
35. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës shtojnë se Presidenti ka vepruar në kundërshtim me parimet kushtetuese, në shkelje të nenit 83 [Statusi i Presidentit] të Kushtetutës, në atë mënyrë që publikisht ka pranuar në disa deklarata për media *“se më 03.06.2020, rreth orës 01:00 të mëngjesit ka vizituar deputetin Haxhi Shalën, duke shtuar ‘Unë jam President i vendit dhe natyrisht se e kam obligim që të takohem me gjithë bartësit e institucioneve të Republikës së Kosovës, me gjithë përfaqësuesit legjitim [...]’”*.
36. Pikërisht, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se deklarata e Presidentit dhe aktorëve të tjerë të asaj ngjarje përmes medieve, dëshmon *“veprimin e tij jokushtetues të bërë qëllimshëm dhe me paramendim duke bindur deputetin*

Haxhi Shala për të ndërruar qëndrim në votimin e Qeverisë Hoti, është shkelje serioze e nenit 83 të Kushtetutës së Kosovës. Kjo dispozitë kushtetuese shpreh qartë se Presidenti është përfaqësues i unitetit të popullit. Nga kjo dispozitë kushtetuese kuptohet se Presidenti i Kosovës nuk lejohet t'j përfaqësojë interesat grupore ose politike partiake por i përfaqëson të gjithë së bashku, që i jep kuptim substancial përfaqësimit të unitetit të popullit të një shteti. Me këtë veprim të kryer me paramendim nga Presidenti i Republikës së Kosovës përcakohet qartë se ai cenon rëndë përfaqësimin e unitetit të popullit duke përfaqësuar brutalisht grupe politike brenda organit më të lartë legjislativ me qëllim që të arrihet vota e 61 si votë për themelimin e qeverisë Hoti”.

37. Si dëshmi për këtë, parashtruesit e kërkesës përmendin deklaratën që ka dhënë deputeti z. Haxhi Shala lidhur me qëndrimin që do ta ketë ai gjatë votimit për Qeverinë, para vizitës së Presidentit. Përkitazi me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“më 1 qershor 2020, Haxhi Shala, deputeti i iniciativës socialdemokrate NISMA, si partnere e koalicionit për formimin e qeverisë me kryeministër Avdullah Hotin, edhe në cilësinë e shefit të Grupit Parlamentar të NISMA, në TV21 deklaroi, se nuk do të votojë qeverinë e këtij koalicionit me Kryeministër Hotin, që mund të vërtetohet në bazë të transkripteve të dorëzuara në Gjykatë”.*
38. Në dritën e këtyre pretendimeve, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se Presidenti ka shkelur nenin 83 të Kushtetutës sepse ai përdori mekanizma antikushtetues gjatë vizitës së tij private në shtëpinë e deputetit z. Haxhi Shala, që rezultoi në atë që deputeti z. Haxhi Shala, votoi për formimin e qeverisë së z. Avdullah Hoti, edhe pse deputeti në fjalë deklaroi para mbajtjes së seancës plenare se ai do të votojë “kundër” formimit të qeverisë.
39. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë më tej se, *“pas mocionit të suksesshëm kundër Qeverisë, Presidenti i Republikës së Kosovës sipas nenit 84 par.2 në lidhje me nenin 84 par.14 të Kushtetutës ka materializuar këto kompetenca konkrete kushtetuese duke ia transferuar emrin e kandidatit për Kryeministër Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës për votimin e Qeverisë së Kosovës”.*
40. Parashtruesit e kërkesës specifikojnë që në nenin 84, paragrafi 2 përcaktohet qartë se Presidenti *“garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë kushtetutë”.* Po ashtu në nenin 4, paragrafi 3 përcaktohet se: *“Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë”.* Ndërsa në nenin 84, par. 14 përcaktohet se *“Presidenti cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit”.* Sipas parashtruesit të kërkesës, këto nene parashohin me saktësi një fushë të kufizuar të veprimit të tij kushtetues. Çdo shkelje e kësaj fushe nga procedura të caktuara është shkelje e rëndë/serioze e dispozitave përkatëse kushtetuese.
41. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që me veprimin e tij antikushtetues, Presidenti ka shkelur seriozisht nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës,

dhe me këtë edhe kompetencat e Kuvendit të Kosovës, përkatësisht nenin 65, paragrafi 8 të Kushtetutës, dhe Gjykata Kushtetuese tashmë ka konkluduar në aktgjykimin e saj KO 43/19, ku deklaroi: “Gjykata rikujton, se në kuadër të nenit 4 të Kushtetutës, i cili përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, Kuvendi si përfaqësues i popullit sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Kushtetutës, është në të njëjtën kohë edhe organi më i lartë i cili ushtron pushtetin legjislativ; Presidenti i Republikës së Kosovës sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Kushtetutës përfaqëson unitetin e popullit, si dhe është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës sipas paragrafit 4 të nenit 4 të Kushtetutës, është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar nga ana e Kuvendit. Me këtë rast, Gjykata thekson se, parimi i ndarjes së pushteteve, paraqet vlerë demokratike, në kuadër të organizimit të rendit kushtetues në Republikën e Kosovës”. Në pjesën e fundit të këtij paragrafi Gjykata Kushtetuese përcakton rëndësinë që e ka parimi i ndarjes së pushtetit në kuptim të nenit 7 të Kushtetutës, duke e cilësuar këtë parim si vlerë demokratike mbi të cilin qëndron rendi kushtetues. Përveç kësaj, “Presidenti i Republikës së Kosovës [...] siguron respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve dhe ruan sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues”.

42. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës shtojnë se sjellja e Presidentit është në kundërshtim me mendimin e Gjykatës Kushtetuese të dhënë në paragrafin 67 të Aktgjykimit KO 43/19 “Gjykata vëren se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës ndër të tjera, bazohet në vlerat demokratike të ndarjes së pushtetit dhe sundimit të ligjit. Rrjedhimisht, besimi i popullit në vlerat demokratike dhe sundim të ligjit, paraqet thelbin e funksionimit të demokracisë përfaqësuese në vend. Gjykata, gjithashtu rikujton dhe praktikën e saj të mëhershme, ku thekson se Kuvendi është institucioni që ka përgjegjësinë e ushtrimit të pushtetit legjislativ, ndërsa Qeveria ushtron pushtetin e ekzekutiv në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të miratuara në Kuvend”.
43. Prandaj, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “Presidenti i Kosovës ka cenuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe njëkohësisht ka cenuar pavarësinë Kuvendit të Kosovës duke ndërhyrë brutalisht në kompetencat e tij. Kësisoj Presidenti ka cenuar respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve dhe ka cenuar ruajtjen sigurisë në rendin juridik dhe kushtetues. Gjithashtu, Presidenti i Kosovës si institucion kushtetues përmes cenimit të parimit të ndarjes së pushtetit shtetëror, ku njëra ndër degët e pushtetit shtetëror është edhe Kuvendi, ka cenuar drejtpërdrejtë dhe në formën më të rëndë pavarësinë dhe kompetencat e Kuvendit, konkretisht nenin 65 par. 8 të Kushtetutës”.
44. Më tej, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “sipas nenit 64 të Kushtetutës, ka 120 deputetë. Në nenin 65 të Kushtetutës është përcaktuar se “Kuvendi i Kosovës zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj”. Kjo dispozitë kushtetuese vjen në shprehje vetëm pasi presidenti të mandaton kandidatin për kryeministër të Kosovës sipas nenit 84 par. 14. Në lidhje me këtë, Kuvendi i Kosovës në seancën e 3 qershorit 2020, ka zgjedhur qeverinë Hoti me 61 vota, vetëm pasi në atë seancë para votimit të qeverisë ka ndërruar qëndrim deputeti Haxhi Shala, pas një nxitjes, presionit, apo edhe në bazë të ndonjë

ndikimi tjetër politik që është bërë atij, nga ana e Presidentit. Në këtë aspekt, pala parashtruese duke u bazuar në faktet kushtetuese pretendon se është cenuar pavarësia e Kuvendit të Kosovës duke ndërhyre nën dritën e ndikimeve politike në deputetë të caktuar për të votuar qeverinë e Hotit. Kësisoj ndërhyrja përmes ndikimit politik dhe formave tjera të ndikimeve mbi deputetin e caktuar cilësohet si ndërhyrje dhe cenim të kompetencës konkrete të Kuvendit, konkretisht nenit 65 par. 8 të Kushtetutës”.

45. *Parashtruesit e kërkesës rikujtojnë nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke theksuar “se ai përcakton qartë hierarkinë e akteve juridike dhe detyrimin që të gjitha duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën. Po ashtu, një element tjetër që mund ta nxjerrim nga ky nen është se, pushteti qeverisës buron nga kushtetua dhe në përmbyllje të këtij neni përcaktohet një paragraf që ka rëndësi jetike lidhur me atë se “Secili person dhe organ në Republikës së Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës së Kosovës”.*
46. *Prandaj, ndikimi i Presidentit i bërë prej tij, sipas parashtruesve të kërkesës “nuk ka të bëjë asgjë me parimin e ndarjes së pushteteve si vlerë demokratike me të cilin bazohet rendi kushtetues. Përkundrazi ky veprim i Presidentit cenon rëndë këtë parim dhe rendin kushtetues. Ky ndikim i drejtëpërdrejtë dhe brutal i bërë nga presidenti Thaçi ndaj deputetit Haxhi Shala, konsiston në shkelje të rëndë të nenit 83 lidhur me nenin 84 par. 2,14, nenit 4.3 dhe nenit 7 të Kushtetutës. Ky ndikim i pashembulltë në demokracitë liberale kushtetuese ka cenuar pavarësinë dhe kompetencat e Kuvendit të Kosovës, konkretisht nenin 65.8 të Kushtetutës. Ky ndikim politik i cili nuk zë vend në asnjë dispozitë kushtetuese, nuk është asgjë tjetër përveç shkelje e rëndë e nenit 16 të Kushtetutës së Kosovës”.*
47. *Parashtruesit konsiderojnë që niveli i besueshmërisë publike mbi rolin e Presidentit, në ushtrimin e kompetencave të tij kushtetuese, “duhet trajtuar në dritën e rastit KI 47/10 Naim Rustemi dhe deputetët e tjerë kundër ish-Presidentit Fatmir Sejdiu, me ç’rast provohet qartazi se niveli i shkeljeve kushtetuese me veprimin antikushtetues të Presidentit të Republikës së Kosovës, tejkalon dukshëm si për nga cilësia ashtu edhe për nga vëllimi, nivelin e shkeljeve të përcaktuara në rastin KI 47/10, Naim Rustemi dhe të tjerët kundër Presidentit të Republikës së Kosovës”.*
48. *Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën e tyre të pranueshme dhe të konstatojë se ka pasur shkelje të rënda të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 4, paragrafi 3, nenit 7, nenit 16, paragrafi 8, nenit 83, nenit 84. paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 14 dhe nenin 65, paragrafi 8 të Kushtetutës, nga Hashim Thaçi në cilësinë e tij si President i Republikës së Kosovës, i cili ndikoi, inkurajoi dhe bindi në forma të ndryshme deputetin Haxhi Shala të ndryshojë qëndrimin e tij dhe të votojë për zgjedhjen e Qeverisë në seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 3 qershor 2020.*

Kërkesa e parashtruesve për seancë dëgjimore publike

49. Në kërkesën e tyre, parashtruesit kërkuar që të mbahet seancë dëgjimore publike. Në lidhje me këtë kërkesë, parashtruesit e kërkesës deklarojnë se *“bazuar në Rregulloren e Punës së Gjykatës, Rregulli 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dore], par. 1 dhe 2, me qëllim të qartësimit të çështjes së provave të ofruara, nëse Gjykata e konsideron se sqarime shtesë për dëshmitë dhe Kërkesën janë të nevojshme, parashtruesit e Kërkesës kërkojnë që Gjykata të lejojë mbajtjen e seancës dëgjimore para Gjykatës”*.

Përgjigja e Presidentit

50. Gjykata rikujton se më 15 korrik 2020 Presidenti i dorëzoi Gjykatës përgjigje voluminoze në kërkesën e 30 qershorit 2020. Kësisoj, Gjykata do ta përmbledhë përgjigjen e Presidentit, me qëllim që të paraqesë në mënyrën më të mirë esencën e saj.
51. Në përgjigjen e tij, Presidenti konsideron, para së gjithash, që kërkesa në rastin KO103/20 duhet të deklarohet e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese, për faktin se është e paqartë si në specifikimin e saj ashtu edhe në arsyetimin e saj. Në mbështetje të këtij pretendimi, Presidenti në përgjigjen e tij deklaron:

“Parashtruesit e kërkesës në rastin KO103/20, kontestojnë kushtetutshmërinë e veprimit të Presidentit të Republikës së Kosovës (Presidenti) të datës 03.06.2020, lidhur me vizitën e tij, në shtëpinë/banesën private të Haxhi Shalës, i cili mbanë pozitën e deputetit të subjektit politik NISMA në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe pretendojnë që Presidenti ka bërë shkelje serioze të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (Kushtetuta). Parashtruesit e kërkesës e kanë të paqartë se cilat nene të Kushtetutës janë shkelë nga Presidenti. Gjersa në Pikën 8 të kërkesës së tyre cekin (citim): [...] Presidenti ka shkelë Nenin 83, Nenin 4 par. 1 dhe 3, në lidhje me Nenin 84 paragrafi 2 dhe Nenin 88 paragrafi 1 dhe të Kushtetutës”. Ndërsa, po në këtë pikë citojnë nenet në vijim të Kushtetutës: Nenin 4, paragrafët 1 dhe 3 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; Nenin 7 [Vlerat]; Nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës]; Nenin 83 [Statusi i Presidentit], Nenin 84 pikën 2 [Kompetencat e Presidentit], dhe Nenin 65 paragrafi 8 [Kompetencat e Kuvendit]. Përveç kësaj, pasaktësi të shumta vërehen gjatë gjithë kërkesës dhe arsyetimeve përkatëse që kanë dhënë parashtruesit e kërkesës”.

52. Megjithatë, përkundër faktit që Presidenti konsideron se kjo kërkesë duhet të deklarohet e papranueshme, në vazhdim ai u përgjigjet pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, duke theksuar rolin dhe rëndësinë e funksionit të Presidentit të Shtetit.
53. Me këtë rast, Presidenti konsideron *“se në radhë të parë duhet pasur parasysh rolin e Presidentit sipas Kushtetutës, si dhe pushtetin, funksionet, detyrat dhe kompetencat e tij që përcaktohen jo vetëm në nenin 84, por edhe në nenet e tjera të Kushtetutës, siç janë nenet: 4, 18, 60, 66, 69, 79, 80, 82, 83, 93, 94, 95, 103, 104, 109, 113, 114, 118, 126, 127, 129, 131, 136, 139 dhe 144, kompetencat që ushtron në bazë të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së*

Kosovës (GZ / Nr. 47 / 25 janar 2009), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-004 (GZ, Nr. 4, 23 prill 2018), dhe me ligjet tjera në fuqi. Të gjitha këto nene të Kushtetutës lë cekura me lartë dhe dispozita ligjore të veçanta në ligje të ndryshme paraqesin tërësinë e rolit që ka Presidenti në sistemin kushtetues dhe juridik të Kosovës, i bazuar para së gjithash në Kushtetutë, por edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese me të drejtë vëren se: „Presidenti ushtron funksione unike që i janë dhënë vetëm atij/asaj. Sipas Kushtetutës, Presidenti duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës për t'i kryer këto funksione. [...]. Presidenti duhet përherë të jetë në dispozicion për t'i kryer funksionet e institucioneve dhe çështjet e shtetit. ' Parashtruesit e kërkesës nuk e kanë të qartë ende rolin dhe funksionet e Presidentit bazuar para së gjithash në nenet e mësipërme të Kushtetutës, Ligjin nr. 03/L-094 për Presidentine Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi”.

54. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, se vetë veprimi i vizitës së Presidentit në shtëpinë e z. Haxhi Shala, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, para mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, paraqet shkelje serioze të nenit 4, paragrafi 3, nenit 83 dhe nenit 84, paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 14 të Kushtetutës, Presidenti në letrën e tij theksoi;

“Vizita miqësore e Presidentit në shtëpi të Haxhi Shala, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 03.06.2020, nuk bie ndesh në asnjë moment me fushëveprimin kushtetues dhe kompetencat e Presidentit. Vizita e Presidentit të Republikës së Kosovës tek një deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, aq me tepër kur të dytë kanë edhe njohje shumë të hershme nuk paraqet shkelje të asnjë neni të Kushtetutës, e si rrjedhojë as të neneve të Kushtetutës që parashtruesit e kërkesës pretendojnë. Për më tepër, rikujtojmë se neni 4 paragrafi 3, nenin 53 dhe nenin 84 paragrafi 2 të Kushtetutës [...].

Që të tria këto kompetenca (të përcaktuara në nenin 4 paragrafi 3, nenin 83 dhe nenin 84 paragrafi 2 të Kushtetutës) përbëjnë boshtin kryesor të rolit të Presidentit në sistemin kushtetues të KOSOVËS. Presidenti përmes ushtrimit të këtyre kompetencave materializon të gjitha kompetencat e tjera të cilat ia garanton Kushtetuta si dhe kujdeset për balancimin e pushteteve si dhe krijimin dhe funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese në Republikën e Kosovës.

Presidenti, si përfaqësues i unitetit të popullit, në çdo veprim ka pasur parasysh interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Presidenti kryen funksione të veçanta dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ndalohej në kryerjen e këtyre funksioneve, sepse kjo bie në kundërshtim me përfaqësimin e unitetit të popullit nga Presidenti. Kështu konstaton Gjykata Kushtetuese ndër të tjera në Aktgjykimin në rastin nr. KO98/11, në pikën 127: “....ndalimi i një personi të tillë është në kundërshtim me ato ideale të Presidentit që përfaqëson unitetin e popullit dhe mishëron shtetësinë si kreu i shtetit...”.

55. Në pjesën e dytë të përgjigjes, Presidenti paraqiti një *“Përmbledhje të fakteve lidhur me rrethanat e rastit dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës”* duke komentuar veprimet dhe ngjarjet paraprahe, sepse sipas tij *“ duhet pasur parasysh rrjedhën e veprimeve dhe ngjarjeve si tërësi dhe jo vetëm vizitën e Presidentit me 03.06.2020 në shtëpinë e z. Haxhi Shala, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës”*. Në lidhje me këtë Presidenti komentoj veprimet e tij te ndërmarra në lidhje me: i) Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë, ii) Takime me liderë të partive politike të përfaqësuara në Kuvend (1 dhe 2 prill 2020), iii) Shkresa nga Presidenti drejtuar Lëvizjes Vetëvendosje për propozimin e kandidatit për formimin e Qeverisë, iv) Konsultime me liderët e partive politike të përfaqësuar në Kuvend (22 prill 2020), c) Shkresë nga Presidenti drejtuar Aleancës Demokratike të Kosovës me kërkesë për të propozuar kandidatin për formimin e Qeverisë, vi) Propozimi i kandidatit nga Lidhja Demokratike e Kosovës për formimin e Qeverisë, vii) Vlerësimet e kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit nr. 24/2020 (të 30.04.2020), viii) Zgjedhja e Qeverisë së dytë në Pushtetin VII Legjislativ të Kuvendit, e gjitha me qëllim që të sigurojë një përmbledhje të të gjitha veprimeve të ndërmarra prej tij si President, duke deklaruar *“se të gjitha veprimet e mëparshme të Presidentit ishin përqendruar në ruajtjen e stabilitetit të vendit dhe garantimin e vullnetit të partive politike për të pasur një Qeveri të re”*.
56. Në vazhdim të përgjigjes së tij, Presidenti dha përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me deklaratat e bëra nga deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Haxhi Shala para seancës plenare të Kuvendit, si dhe deklaratat që ai bëri gjatë seancës plenare. Me atë rast, Presidenti përgjigjet:

“Deklarimet e deputetëve duke përfshirë edhe deklaratën e deputetit Haxhi Shala në seancën e Jashtëzakonshme plenare të Kuvendit, të datës 3 qershor 2020, i cili në fjalimin e tij theksoi se “para dy ditëve kam deklaruar se nuk do të votoj Qeverinë Hoti për arsye të i monopolizmit të partisë Nisma për Kosovën nga dy persona. Por, mbrëmë pas vizitës që kam pasur në familjen time të Presidentit dhe ish Kryeministrit Haradinaj, kam ndërruar mendje, dhe vota ime do të jetë për këta dy persona, pro Qeverisë Hoti”, janë deklarime politike dhe në asnjë moment nuk përkon me ndonjë veprim që Presidenti të këtë bërë presion apo të këtë ndikuar tek deputeti Shala. Bazuar në nenin 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 3 dhe nenin 39 të Ligjit Nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (GZ / Nr. 74 / 20 korrik 2010), Deputeti Haxhi Shala ka ushtruar funksionin e tij pa pasur ndikim apo presion nga Presidenti lidhur me votimin “për” në lidhje me zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës në seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit. Deputeti Haxhi Shala është përfaqësues i qytetarëve të Kosovës dhe gjatë mandatit të tij i nënshtrohet vetëm ndërgjegjes së tij, pa u ndikuar nga të tjerët, detyrat e tij i ushtron në pajtim me dispozitat kushtetuese, Ligjin Nr. 03/L-111 Për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit. Vizita e Presidentit në shtëpinë e deputetit Haxhi Shala ishte një vizitë miqësore, konsultative pa ndonjë presion apo ndikim, andaj pretendimet e parashtruesve të kërkesës

se vizita e Presidentit në shtëpinë e deputetit Haxhi Shala paraqet veprim kundërkushtetues nuk qëndrojnë”.

57. Në fund të përgjigjes së tij, Presidenti përmbledhi përgjigjet e tij në disa pika, dhe dha konkluzionet e tij, si më poshtë:

“Deputeti Haxhi Shala, ka qenë nënshkrues i listës që e ka përkrah Mocionin e Mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës me datën 20.03.2020.

Deputeti Haxhi Shala, ka qenë nënshkrues i listës që e ka përkrah formimin e Qeverisë së re, e cila listë me nënshkrimet e gjashtëdhjetë e një (61) deputetëve, ka qenë pjesë e shkresës së Kryetarit të LDK-së, që me datën 30.04.2020 i propozuan Presidentit, z. Avdullah Hoti, kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Në asnjë mënyrë Presidenti në vizitën miqësore të realizuar në shtëpi të Deputetit Haxhi Shala, nuk ka vepruar njëanshëm politikisht apo ndikuar në vendimin e tij, vendimi i deputetit Shala për Presidentin ka qenë i njohur qysh me 30.04.2020, kur LDK ka propozuar kandidatin për Kryeministër. Presidenti në të gjitha rastet, edhe në këtë rast ka vepruar gjithnjë në të mirën publike dhe te interesit dhe shëndetit të qytetarëve, dhe të vlerave kushtetuese të Republikës së Kosovës”.

58. Prandaj, Presidenti konsideron se në bazë të gjitha të cekurave më lart mund të konkludohet se:

“Presidenti në realizimin e vizitës miqësore të tij tek shtëpia e Deputetit Haxhi Shala para Seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit të datës 03.06.2020, nuk ka shkelur asnjërin nga nenet kushtetuese të pretenduara nga parashtresit e kërkesës;

Presidenti, gjatë gjithë mandatit të tij edhe në rastin e formimit të Qeverisë së re, ka vepruar veçanërisht duke pasur për bazë kompetencat e tij si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garantues i funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve;

Presidenti e ka pas të njohur vendimin e deputetit Haxhi Shala, në përkrahje të Qeverisë së re, nga data 30.04.2020, kur LDK ka dërguar listën e nënshkrimeve në Presidencë, me emrat e deputetëve që do të përkrahin kandidatin e tyre për Kryeministër, ku në mesin e deputetëve nënshkrues ishte edhe deputeti Shala.

Andaj bazuar në këto argumente, kërkesa KO 103/20, duhet të shpallet e papranueshme , sepse nuk është në pajtim racione materiae me Kushtetutën”.

59. Përveç përgjigjes së tij ndaj pretendimeve të parashtresve të kërkesës, Presidenti gjithashtu dorëzoi shkresa në Gjykatë, dhe atë;

- a) Shtojca 1: Kërkesa për Mocionin e Mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës (20.03.2020), ku figuron edhe nënshkrimi i Deputetit z. Haxhi Shala;
- b) Shtojca 2: Propozimi i kandidatit për formimin e Qeverisë nga Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (Ref.: nr. 409, i 30.04.2020), ku figuron edhe nënshkrimi i deputetit z. Haxhi Shala.

Dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Neni 4
[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

[...]

3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

Neni 7
[Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”.

Neni 16
[Epërsia e Kushtetutës]

“1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.

2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.

[...]

4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës”.

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

[...]

(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit”.

Kapitulli V
Presidenti i Republikës së Kosovës

Neni 83 [Statusi i Presidentit]

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë.

[...]

(20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;

(21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendës drejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;

(22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;

(23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;

(24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;

(25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;

[...].

Përkitazi me procedurën e shqyrtimit të kërkesës

60. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë lidhur me kërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
61. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton se më 30 qershor 2020, parashtruesit e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë, në të cilën pretendojnë se

“veprimi i vizitës” së Presidentit të Republikës së Kosovës në shtëpinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës përbën shkelje serioze të Kushtetutës, përkatësisht nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 14, paragrafi 3 i nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], neni 7 [Vlerat], neni 16 [Epërsia e Kushtetutës], neni 65 paragrafi 8 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës.

62. Si rrjedhojë e parashtrimit të kërkesës së parashtruesve, Gjykata, në pajtim me dispozitat e aplikueshme ligjore, ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme për të njoftuar palët e interesuara për regjistrimin e kërkesës së tyre në Gjykatë, siç janë reflektuar në paragrafët 8 deri 12 të këtij Vendimi.
63. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore sipas të cilave deputetët mund të paraqiten si palë e autorizuar para kësaj Gjykate dhe të kërkojnë vlerësimin e pretendimit të tyre nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës”.

[...]

Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

KREU III

PROCEDURAT E VEÇANTA

9. Procedura në rastet e përcaktuar në nenin 113, paragrafi 2 (1) dhe (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Neni 44

Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar(supozuar);

1.2. dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se i ka shkelur Presidenti; dhe

1.3 paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës.

Neni 45 Afatet

Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike.

Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese

VII. Dispozita të veçanta për procedura sipas nenit 113 të Kushtetutës

Rregulli 75

Kërkesa në pajtim me nenin 113.6 të Kushtetutës dhe me nenet 44 dhe 45 të Ligjit

(1) Kërkesa, e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në nenin 113.6 të Kushtetutës dhe me nenet 44 dhe 45 të Ligjit.

(2) Kërkesa, e bërë sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

(a) përshkrimin e fakteve për shkeljen e pretenduar;

(b) dispozitat konkrete të Kushtetutës për të cilat pretendohet se i ka shkelur Presidenti i Republikës së Kosovës; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

(3) Pas paraqitjes së kërkesës në pajtim këtë rregull, Gjykata menjëherë njofton Presidentin e Republikës së Kosovës dhe i dërgon një kopje të kërkesës jo më vonë se tre (3) ditë nga paraqitja e saj në Gjykatë

(4) Gjykata i kërkon Presidentit të Republikës së Kosovës që t'i përgjigjet kërkesës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur kërkesa i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës, përveç rastit kur tregohet një arsye e mirë për një përgjigje të mëvonshme dhe kur jepet leja përkatëse.

(5) Gjykata urdhëron ndërprerjen e procedurave të iniciuara në pajtim këtë rregull në rast se para nxjerrjes së vendimit të saj, Presidenti i Republikës së Kosovës ka dhënë dorëheqje ose ka ndërprerë mandatin e tij/ saj.

(6) Në rast se pala e autorizuar e tërheq kërkesën, Presidenti i Republikës së Kosovës mund të kërkojë nga Gjykata të vazhdojë me procedurën dhe të

nxjerrë vendim. Një kërkesë e tillë do të vendoset nga Gjykata me shumicën e gjyqtarëve.

(7) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike.

[...]

64. Në vijim të kësaj, Gjykata duke u bazuar në të gjitha kriteret e përcaktuara me dispozitat e lartcekura të Kushtetutës, të Ligjit dhe Rregullores së punës konstaton se: (i) kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar siç është përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 113 të Kushtetutës; (ii) kërkesa është parashtruar brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike, siç është përcaktuar me nenin 45 të Ligjit dhe paragrafin (1) të rregullit 75 të Rregullores së punës; dhe (iii) parashtruesit e kërkesës kanë saktësuar kërkesën e tyre ashtu siç është përcaktuar me nenin 44 të Ligjit dhe paragrafin (2) të rregullit 75 të Rregullores së punës.
65. Megjithatë, para se Gjykata të vendos përfundimisht në lidhje me kërkesën e parashtruesve, përmes së cilës pretendohej kryerja e shkeljes serioze të Kushtetutës nga Presidenti, më 5 nëntor 2020, Presidenti i Republikës së Kosovës dha dorëheqje nga pozita e Presidentit.
66. Në kontekst të rrethanave specifike, që janë krijuar si rezultat i dorëheqjes së Presidentit nga pozita e tij si President i Republikës së Kosovës, Gjykata në këtë rast i referohet paragrafit (5), të rregullit 75, i cili parashikon:

(5) Gjykata urdhëron ndërprerjen e procedurave të iniciuara në pajtim këtë rregull në rast se para nxjerrjes së vendimit të saj, Presidenti i Republikës së Kosovës ka dhënë dorëheqje ose ka ndërprerë mandatin e tij/ saj.

67. Në dritën e sa më sipër, Gjykata thekson se paragrafi (5) i rregullit 75 përcakton detyrimin e Gjykatës që të veprojë në pajtim me rrethanat e krijuara, gjegjësisht rrethanën e dhënies së dorëheqjes së Presidentit pas fillimit të procedurës, përkatësisht pasi parashtruesit parashtruan kërkesën në pajtim me paragrafin 6 të nenit 11 të Kushtetutës dhe para nxjerrjes së vendimit të saj përfundimtar në lidhje me kërkesën. Kjo dispozitë e Rregullores së punës shprehimisht përcakton që në rast të dorëheqjes apo ndërprerjes së mandatit të Presidentit para nxjerrjes së vendimit të saj përkitazi me vlerësimin e pretendimit nëse Presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës, Gjykata urdhëron ndërprerjen e procedurave të filluara sipas paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës.
68. Gjykata rikujton që pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës kishte të bënte me veprimin e “vizitës së Presidentit të Republikës së Kosovës në shtëpinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, i 3 qershor 2020 me ç’rast pretendohet se ka ardhur deri te ndryshimi i qëndrimit të tij të mëparshëm në lidhje me votimin e propozimit për të formuar qeverinë e re, me mandatarin z. Avdullah Hoti.

69. Bazuar në të lartcekurat, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Presidenti me këtë veprim ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës, duke pretenduar konkretisht se (i) Presidenti në këtë mënyrë ka kryer një akt antikushtetues me paramendim duke bindur deputetin e Republikës së Kosovës Haxhi Shala ta ndryshojë qëndrimin e tij në votimin e Qeverisë, dhe ka shkelur rëndë ndarjen demokratike të pushtetit; (ii) se me këtë ka shkelur nenin 83, nenin 84, paragrafin 2, në lidhje me paragrafin 14 [Kompetencat e Presidentit], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] [Vlerat], neni 16 [Epërsia e Kushtetutës] dhe neni 65 [Kompetencat e Kuvendit] paragrafi 8 i Kushtetutës nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
70. Prandaj, bazuar në atë si më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet se Presidenti ka kryer shkelje serioze ndërlidhen posaçërisht me veprimet e Presidentit gjatë ushtrimit të funksionit të tij si President dhe për pasojë, përgjegjësia e Presidentit ose pretendimi për shkelje serioze të Kushtetutës ndërlidhet ekskluzivisht me ushtrimin e funksionit të tij si President.
71. Në kontekst të kësaj, dhe duke iu referuar paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës, është përcaktuar se subjekt i vlerësimit të Gjykatës është “Presidenti i Republikës”, përkatësisht vlerësimi nëse veprimi i tij i pretenduar, të cilin ai pretendohet se e ka kryer si President i Republikës, përbën shkelje serioze të Kushtetutës. Rrjedhimisht, dhe në pajtim me rregullin 75 paragrafin (5) të Rregullores së punës, Gjykata vlerëson se procedura e shqyrtimit, përkatësisht vlerësimit nëse Presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës nuk mund të vazhdohet për arsye se personi që ka ushtruar funksionin e Presidentit të Republikës, më 5 nëntor 2020 ka dhënë dorëheqje nga ai funksion, dhe rrjedhimisht ai nuk e ushtron më. Krahas kësaj, pasojat që pretendohet të kenë rezultuar nga veprimi i tij i pretenduar, me dorëheqjen e 5 nëntorit 2020, si të tilla kanë pushuar së ekzistuari.
72. Në këtë rast, Gjykata i referohet paragrafit 3 të nenit 91 [Shkarkimi i Presidentit] të Kushtetutës, i cili përcakton që:
- 3. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.*
73. Gjykata rikujton se një situatë të ngjashme e ka trajtuar edhe në kërkesën KO56/20, parashtrues të kërkesës *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, ku në paragrafët 92 dhe 93 të Vendimit për ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës, ka konkluduar: “Duke qenë se Presidenti ka dhënë tashmë dorëheqje dhe nuk është më në detyrë, ky fakt e bën dispozitën e paragrafit 3 të nenit 91 të Kushtetutës të pazbatueshme në kuptimin që Kuvendi nuk ka se si ta shkarkojë atë po qe se Gjykata do të gjente se ai e ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës” (shih vendimin e Gjykatës në rastin KO56/20 *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të*

Republikës së Kosovës për ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës së 17 dhjetorit 2020, paragrafi 92).

74. Bazuar në atë si më lart, Gjykata thekson se në rast se ushtrimi i detyrës të Presidentit ka përfunduar si rezultat i dorëheqjes së tij, paragrafi 3 i nenit 91 të Kushtetutës nuk mund të vihet në lëvizje (shih vendimin e Gjykatës në rastin KO56/20 *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* për ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës së 17 dhjetorit 2020, paragrafi 93).
75. Gjykata edhe në këtë rast, sikurse në rastin KO56/20 *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, bën dallimin në mes të kërkesës së parashtruar në bazë të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe kërkesës së parashtruar në bazë të paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës.
76. Përderisa bazuar në paragrafin 2 të nenit 113 të Kushtetutës, objekt i vlerësimit është, përveç tjerash, çështja e përputhshmërisë së dekreteve të Presidentit me Kushtetutën, gjë që është e pavarur nga personi që e ushtron funksionin e Presidentit dhe fakti nëse i njëjti vazhdon të jetë në detyrë ose jo, në rastin e paragrafit 6 të nenit 113, çështja është e lidhur me personin dhe veprimet e personit që e ushtron funksionin dhe me vlerësimin nëse i njëjti person me atë rast ka kryer shkelje ose jo, dhe përcaktimi i ekzistimit të shkeljeve të tilla ka efekte të drejtpërdrejta për bartësin e funksionit. Thënë ndryshe, në rastin e një çështjeje që ngritet në mënyrë të vlefshme mbi bazën e paragrafit 2 të nenit 113, Gjykata mund të vendosë për kushtetutshmërinë e një dekreti të Presidentit, pavarësisht nga fakti nëse Presidenti që ka nxjerrë dekretin e kontestuar është në detyrë ose duke ushtruar funksionin ose jo.
77. Në rrethanat e rastit konkret, kërkesa është dorëzuar në kuadër të paragrafit 6 të nenit 113 të Kushtetutës me ç'rast parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e veprimit të Presidentit që pretendohet ta ketë kryer më 3 qershor 2020. Thënë këtë, veprimi i kontestuar i Presidentit nuk përbën as ligj e as dekret nga neni 113.2 i Kushtetutës, por përbën veprim, i cili ka qene i ndërlidhur me personalitetin e Presidentit.
78. Rrjedhimisht, bazuar në faktin se kërkesa është dorëzuar në bazë të nenit 113, paragrafit 6 të Kushtetutës, me ç'rast parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e veprimit të Presidentit që pretendohet të jetë bërë më 3 qershor 2020 gjatë vizitës së tij në shtëpinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili veprim rrjedhimisht, ndërlidhet me kërkesën për konstatimin e një shkelje serioze që do të mund të rezultonte në shkarkimin e Presidentit, dhe që Presidenti më nuk e ushtron këtë detyrë, Gjykata në pajtim me nenin 113.6 të Kushtetutës, nenet 44 dhe 45 të Ligjit, dhe rregullin 75 (5) të Rregullores së punës, konstaton se më nuk ka rast para vetes dhe rrjedhimisht duhet të vendosë për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të mëtejme të kërkesës.

Kërkesa për mbajtjen e seancës dëgjimore publike

79. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore publike. Në kontekst të kërkesës së tyre, parashtruesit e

kërkesës theksojnë se, “bazuar në Rregulloren e Punës së Gjykatës, Rregulli 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë], par. 1 dhe 2, me qëllim të qartësimit të çështjes së provave të ofruara, nëse Gjykata e konsideron se sqarime shtesë për dëshmitë dhe Kërkesën janë të nevojshme, parashtresit e Kërkesës kërkojnë që Gjykata të lejojë mbajtjen e seancës dëgjimore para Gjykatës”.

80. Në këtë rast, Gjykata rikujton paragrafin 2 të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit”.

81. Marrë për bazë urdhrin e Gjykatës për ndërprerjen e procedurës së shqyrtimit të kërkesës si pasojë e dhënies së dorëheqjes së Presidentit nga pozita e Presidentit, ky urdhër i Gjykatës i referohet edhe ndërprerjes së shqyrtimit të kërkesës së parashtresve të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafin 6 të Kushtetutës, nenet 44 dhe 45 të Ligjit, rregullin 59 dhe paragrafin (5) të rregullit 75 të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË NDËRPRESE procedurën e shqyrtimit të kërkesës së parashtresve të kërkesës;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi